

VENDIM
Nr.33, datë 8.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 19.09.2005, 4.10.2005 dhe 7.11.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.37 Akti, që i përket:

KËRKUES: KUJTIM SULAJ, përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SHAQO NOVRUZI
2. PAVLINA NOVRUZI
3. NERTILA E JONILA NOVRUZI, në mungesë.
4. RIZA HICKA, në mungesë.
5. LUÇIJE MOZALI, në mungesë.
6. DOROTEA ZOTO, në mungesë.
7. MARIE ZORBA, në mungesë.
8. MUHAMET BAWAZER, në mungesë.
9. NDËRMARRJA KOMUNALE BANESA TIRANË, në mungesë.
10. KOMISIONI I KTHIMIT DHE I KOMPENSIMIT TË PRONAVE PRANË QARKUT TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.1404, datë 6.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 pika 2, 131/f, 134/g dhe 142 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Kërkuesi ka paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese këto shkaqe kryesore:

- Ka kontradiktë të hapur ndërmjet pjesës arsyetuese dhe urdhëruese të këtij vendimi. Në fund të pjesës arsyetuese deklarohet se: “Për rrethanat e çështjes, vendimi i gjykatës së apelit duhet të lihet në fuqi si i bazuar në ligj”. Megjithatë, në pjesën urdhëruese të vendimit theksohet se duhet prishur vendimi i gjykatës së apelit dhe duhet lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Gjykimi i çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë është bërë pa praninë e kërkuesit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuesit, subjektet e interesuara, dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me padinë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes së banesës të lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe subjektit të interesuar Shaqo Novruzi, etj. Subjektet e interesuara Shaqo Novruzi etj. me kundërpadi kanë kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr.61, datë 29.05.1995, me të cilin shtëpia objekt konflikti u jepej motrave Luçije Mozali, Dorotea Zoto dhe Marie Zorba, si trashëgimtare të vetme (ligjore) të të ndjerit Guljelm Luka.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë.

Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar padinë dhe ka rrëzuar kundërpadinë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi pretendon se pikërisht vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me gjykimin kushtetues të një ankese individuale, pretendimet e së cilës duhet të analizohen në kuadër të standardeve apo elementeve përbërëse të procesit të rregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Nga ana tjetër, ajo e quan të nevojshme të ritheksojë se në këtë kuadër mund të trajtojë edhe probleme të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, nëse shkelja që pretendohet, cenon një të drejtë kushtetuese themelore.

Lidhur me pretendimin e parë të kërkuetit, Gjykata Kushtetuese ka parasysh se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim.

Në nenin 142/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë deklarohet qartë shprehimisht detyrimi i gjykatave për të arsyetuar çdo vendim gjyqësor që jepet prej tyre. Kodi i Procedurës Civile përcakton rregulla të sakta për formën dhe përmbajtjen e vendimeve gjyqësore. Nenet 306-309 të këtij Kodi bëjnë fjalë për mënyrën e dhënies së vendimit, si dhe formën e tij. Më tej, në nenin 310 jepet përmbajtja e vendimit të gjykatës. Sipas kësaj dispozite, ky vendim duhet të përmbajë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. Nga ana tjetër, sipas nenit 126 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi përfundimtar, si dhe vendimet që i japin fund procesit gjyqësor civil, të parashikuara nga neni 127 i këtij Kodi (vendimet jopërfundimtare), "...duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, ... dhe mënyrën e zgjidhjes së saj".

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, duke iu referuar procesit të drejtë, garantuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se: "Shtetet gëzojnë liri të konsiderueshme në përzgjedhjen e mjeteve të përshtatshme, të cilat do të garantonin që sistemi i tyre juridik të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës. Megjithatë, gjykatat kombëtare duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi i tyre."¹

Nga sa sipër, del qartë se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik. "E drejta është rregull, dhe e drejta e dhënë logjikisht është e drejtë shumë e mirë", ka thënë Aristoteli.² Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt, në të gjithë komponentët e tij.³

Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe për pasojë nuk mund të zbatohet në praktikë. Një vendim i plotë dhe i kuptueshëm pasohet logjikisht edhe me vetë forcimin e sistemit gjyqësor. Ai kontribuon në shprehjen dhe thellimin e vlerave shoqërore që transmetohen përmes normave ligjore".⁴

Nga dosja gjyqësore rezulton se ka mospërputhje të dukshme ndërmjet pjesës arsyetuese dhe pjesës urdhëruese të vendimit nr.1404, datë 6.07.2004, të dhënë për këtë çështje nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në pjesën arsyetuese nuk gjendet asnjë vlerësim pozitiv apo negativ lidhur me shkaqet e parashtruara nga subjektet e interesuara në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Aty vetëm citohen kryesisht

¹.Çështja Haxhianastasiu kundër Greqisë, Apl. 12945, dt.16.12.1992, si dhe çështja Balani kundër Spanjës, Apl. 18064/91, dt.9.12. 1994

². Aristoteli: Politika, Libri i shtatë, fq. 180, Botimet Plejad 2003 – Tiranë.

³. Shih Christoph Engel "Inconsistency in Law: In search of a balanced norm". Bonn, dhjetor 2004, fq.3

⁴. Po aty.

disa prej fakteve të pranuar në vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit dhe në fund të kësaj pjese të vendimit deklarohet shprehimisht se: “Për rrethanat e mësipërme, vendimi i gjykatës së apelit duhet të lihet në fuqi si i bazuar në ligj”. Megjithatë, në pjesën urdhëruese theksohet se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi: “Prishjen e vendimit... të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit ... të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

Shihet qartë se një vendim i tillë, në tërësinë e tij, është alogjik, i pakuptueshëm e, për rrjedhojë, i pazbatueshëm në praktikë. Pikërisht për këtë arsye, kërkuesi dhe subjektet e interesuara, me pretendime të ndryshme përsa i përket pjesës që duhej ndryshuar, kanë kërkuar më pas korrigjimin e këtij vendimi. Por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1401/1, datë 17.01.2005 të marrë në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e të dyja kërkesave, me arsyetimin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me: “... gabim material në kuptim të nenit 492 të Kodit të Procedurës Civile”. Për këtë arsye, e vetmja mundësi për goditjen e vendimit nr.1404, datë 06.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mbetet paraqitja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, me pretendimin e drejtë se, në këtë rast, kemi të bëjmë me proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi që kundërshtohet nga kërkuesi nuk i plotëson standardet që kërkon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, prandaj duhet të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Përsa i përket pretendimit të dytë të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese çmon se ai është i pabazuar. Nga dosja gjyqësore rezulton se njoftimi i rekursit të paraqitur nga subjektet e interesuara dhe shpallja e ditës së gjykimit të kësaj çështjeje në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, janë bërë në përputhje të plotë me dispozitat respektive të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.1404, datë 6.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.